



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në neneve 13 dhe 58 shkronjat b) dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 14 dhe 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës, nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Genc Gashi, zyrtar në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-Komuna e Podujevës, **caktohet i autorizuar** për ndjekjen e trajnimeve dhe certifikim për punët dhe detyrat që kanë të bëjnë me pozitën e zyrtarit shpenzues në kuadër të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

Neni 2

Caktimi i të përmendurit sipas nenit 1 bëhet me qëllim aftësimin / certifikimit në fushën përkatëse, në mënyrë që në raste të caktuara dhe sipas nevojës dhe vëllimit të shtuar të punëve në pozitën e zyrtarit përkatës të mund t'i kryej punët dhe detyrave të punës të zyrtarit shpenzues, dhe atë deri në rekrutimin e zyrtarit sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 3

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:

Të caktuarit


Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave

Drejtorisë së planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik

Zyrës së personelit

QSHQ / Arkivës

Nr.Prot. 02-016/01-0059809/24
Podujevë, datë, 02.09.2024



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 22 të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.prot.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, Vendimin nr.prot. 01-413/01-0071612/23, të datës 27.09.2023 për Miratimin e Projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2024 dhe Parashikimet Buxhetore 2025-2026, në implementimin e projektit "Përkrahja me mëshqerra", në rekomandim të Komisionit Ad-Hoc të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0028042/24, të datës 29.04.2024 për Shqyrtimin edhe Vlerësimin e Kërkesave për Ndarje të Subvencioneve sipas Njoftimit për vazhdimin e Ftesës Publike nr.12-320/01-0048972/24, të datës 26.07.2024, merr:

V E N D I M

Neni 1

1. Lejohen mjete financiare për subvencionimin e 4 (katër) fermerëve përfitues të Komunës së Podujevës për projektin "Përkrahje me mëshqerra".

2. Mbështetja e fermerëve do të bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara nga Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Ftesën publike për aplikim në projektin "Përkrahje me mëshqerra", përkatësisht fermerët përfitues do të participojnë 30% të vlerës së projektit, kurse pjesa tjetër e projektit mbështetet nga Komuna.

Neni 2

Qëllim i realizimit të këtij projekti është promovimi dhe zhvillimi i bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Neni 3

Lista e aplikuesve të përzgjedhur për implementimin e projektit: "Përkrahje me mëshqerra" sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Për zbatimin e Vendimit kujdeset Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Komisionin për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, i cili do të bëjë verifikimin, konstatimin dhe vlerësimin e përmbushjes së kushteve dhe kriterëve nga ana e fermerit/es si dhe çështjeve tjera të parapara sipas ftesës publike përkatëse.

Neni 5


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. prot 02-400/03-0059964/24
Podujevë, datë 02.09.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenin 11 paragrafi 2, ndërlidhur me nenin 3 paragrafi 3, nenin 26 paragrafi 3, nën paragrafët 3.1, 3.2 dhe 3. 6, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve nr.01-016/01-0030667/22 të datës 29.04.2022, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr.prot.02-020/04-0017955/24 të datës 14.03.2024, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave individuale për ndarje të subvencione, lidhur me shqyrtimin e kërkesës nr.prot 02-400/04-0059719/24, të datës 02.09.2024, merr:

V E N D I M PËR PËRKRAHJE FINANCIARE

Neni 1

znj. [redacted] nga fshati Pakashticë e Epërme, Komuna e Podujevës, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor të familjarit të saj [redacted], si dhe gjendjes së rënduar ekonomiko-sociale të familjes së saj i jepet ndihmë financiare në shumë 1,300.00€.

Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat barten përmes bankës në llogarinë bankare të së përmendurës znj. [redacted]

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e shpenzimit të mjeteve financiare nga kategoria e cekur buxhetore në funksion të realizimit të mbështetjes financiare sipas këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS
Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF
QSHQ/Arkivit
Znj.Lindita Salihu (njoftohet përmes DSHMS-së)

Nr.Prot. 02-400/01-0060488/24
Podujevë, datë, 04.09.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 16 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës merr,

V E N D I M PËR NGRITJEN E KËSHILLIT ORGANIZATIV PËR SHËNIMIN E 26 VJETORIT TË BETEJËS SË KAÇANDOLLIT

Neni 1

Për shënimin e 26 vjetorit të Betejës së Kaçandollit, që do të organizohet më 15 shtator 2024, ngritët Këshilli Organizativ, në këtë përbërje:

- | | |
|---|-----------|
| 1. Marigona Lahu , <i>Nënkryetare e Komunës</i> , | Kryesuese |
| 2. Vlora Humolli Jashanica , <i>Drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit</i> , | anëtare |
| 3. Florim Statovci , <i>përfaqësues i Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së</i> , | anëtar |
| 4. Edona Çitaku , <i>Shefe e Kabinetit të Kryetarit të Komunës</i> , | anëtare |
| 5. Fatri Zhitija , <i>Zëdhënës i Komunës së Podujevës</i> , | anëtar |

Neni 2

Këshilli merret me organizimin dhe përgatitjet e aktiviteteve dhe programeve për shënimin e 26 vjetorit të Betejës së Kaçandollit, që do të mbahet më 15 shtator 2024.


Neni 3

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:
Anëtarëve, përmes Kryesueses së Këshillit
QSHQ / Arkivit

Nr.Prot. 02-016/01-0060629/24
Podujevë, datë, 05.09.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13, ndërlidhur me nenin 17 shkronja g) dhe nenin 58 shkronjat b) g) të Ligjit nr.03/L-040, Ligjit 04/L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, si dhe Rregullores (QRK) nr.25/2020 për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikshmërisë, nenit 14, ndërlidhur me nenin 19 paragrafi 1.7 dhe nenin 61 paragrafët 1.2 dhe 1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, nxjerrë këtë;

V E N D I M **PËR NGRITJEN E GRUPIT PUNUES**

Neni 1

Në kuadër të Komunës së Podujevës, ngritet Grupi Punues për hartimin e Dokumentit për Vlerësimin e Rrezikut, në këtë përbërje:

1. **Bahri Selimi**, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Kryesues
2. **Afrim Mulliqi**, nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, anëtar
3. **Kujtim Zhitia**, nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, anëtar
4. **Naime Ajeti**, nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, anëtare
5. **Milaim Ajvazi**, nga Shërbimi i Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit në Komunën e Podujevës, anëtar
6. **Vail Shala**, nga Kryqi i Kuq – Dega në Podujevë, anëtar
7. **Nazim Veseli**, nga Policia e Kosovës, anëtar
8. **Mirlinda Arifi**, nga Drejtoria e Arsimit, anëtare
9. **Arben Beqiri**, nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Podujevë, anëtar

Neni 2

1. Grupi punues sipas këtij vendimi, harton Dokumentin e Vlerësimit të Rrezikut, duke identifikuar, vlerësuar dhe prioritetizuar rreziqet potenciale, ndërmarrjen e masave parandaluese dhe nevojave specifike për Komunën e Podujevës, Dokument i cili do të shërbej si bazë referente për hartimin e Planit për Reagim Emergjent, Planit Zhvillimor Komunal dhe Planeve tjera kontigjente si dhe planifikimin e menaxhimit të të gjitha situatave emergjente.
2. Dokumenti i Vlerësimit të Rrezikut, përveç tjerash gjithashtu përmban analizë cilësore dhe sasiore të rrethanave natyrore dhe të tjera të lidhura me ndodhitë e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, përfshirë vlerësimin e drejtimit të mundshëm të zhvillimit dhe pasojave të mundshme nga fatkeqësia, nivelin e propozuar të mbrojtjes nga rreziqet përkatëse dhe propozimin për masat parandaluese dhe të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

Neni 3

Grupi punues sipas nenit 1, bashkëpunon dhe koordinon punët dhe aktivitetet me Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, si dhe varësisht nevojave të paraqitura me Drejtoritë, sektorët dhe institucionet tjera relevante të nivelit lokal.

Neni 4

Grupi Punues sipas këtij vendimi angazhohet për kryerjen e punëve dhe hartimin e Dokumentit të cekur në një afat sa më optimal të mundshëm, dhe për punën e kryer informon në formë të shkruar Zyrën e Kryetarit të Komunës, përmes Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtitimit.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

*Anëtarët e Grupit, përmes kryesuesit
Agjencia e Menaxhimit Emergjencë,
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkivi*

Nr.Prot. 02-020/04-0060804/24
Podujevë, datë, 05.09.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 25 të Ligjit nr.08/L-017 për Agjencinë Për parandalimin e Korrupsionit, nenit 53 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031, neneve 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-50862/18, Vendimit 1476/23 të datës 26.07.2023, për Miratimin e Metodologjisë për Planet e Integritetit merr:

V E N D I M

Për Ngritjen e Grupit Punues Për Hartimin e Planit të Integritetit 2024 -2026

I. Caktohet grupi punues për hartimin e Planit të Integritetit, në përputhje me përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, në përbërjen si në vijim:

- znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, koordinatore – kryesuese.
- z.Fatlum Osmani, Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, anëtar.
- z.Avni Fetahu, Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, anëtar.
- znj.Adelina Stublla, Drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, anëtare.
- z.Shuajb Blakçori, Drejtori i Drejtorisë së Administratës, anëtar.
- znj.Lirie Hoti, Drejtoreshë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtare.
- z.Vigan Salihu, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, anëtar.
- znj.Saranda Stublla, Drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, anëtare.
- z.Alban Zeka, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, anëtar.
- znj.Vlora Humolli Jashanica, Drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, anëtare.
- z.Bahri Selimi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim, anëtar.
- z.Leutrim Krasniqi, Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtje së Mjedisit, anëtar.
- z.Osman Bajrami, Zyrtar Ligjor, anëtar.
- z.Nexhat Tovërlani, Udhëheqës për komunikim me publikun, person përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Planit të Integritetit.

II. Obligohet grupi Punues të përgatisë një program për hartimin e Planit të Integritetit, përmes së cilit do të informojë punonjësit për qëllimin, rëndësinë dhe mënyrën e hartimit të Planit të Integritetit, do të vlerësojë gjendjen aktuale të funksionimit të institucionit dhe do të analizojë masat ekzistuese për menaxhimin e rrezikut të korrupsionit, do të vlerësojë intensitetin e rrezikut të korrupsionit, do të propozojë afate dhe persona përgjegjës për zbatimin e masave përmirësuese që ulin rrezikun e korrupsionit, si dhe do të informojnë punonjësit për situatën në institucion duke vlerësuar intensitetin e rrezikut të korrupsionit dhe planin e zbatimit të masave përmirësuese. Grupi Punues mund të përfshijë punonjës të tjerë të institucionit në hartimin e Planit të Integritetit.

III. Grupi i Punës përfundon hartimin e Planit të Integritetit jo më vonë se më datë 11.10.2024.

IV. Personi përgjegjës për miratimin e Planit të Integritetit është z.Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës së Podujevës.

V. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit ndërsa shfuqizohet vendimi nr.prot.02-020/04-0034928/22 i datës 18.05.2022, për ngritjen e grupit punues për hartimin e Planit të Integritetit 2022-2025.

Arsyetim

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale për miratimin e Planeve të Integritetit.

Prandaj, duke e marrë parasysh rëndësinë dhe qëllimin e hartimit dhe të miratimit të Planit të integritetit, si një dokument i cili paraqet rezultatin e vetëvlerësimit të ekspozimit të institucionit ndaj korrupsionit dhe formave tjera të cenimit të integritetit, qëllimi i të cilit është të ruajë dhe përmirësojë integritetin e institucionit duke thjeshtuar procedurat, duke forcuar llogaridhënien, kontrollin e kompetencat diskrecionale, edukimin, forcimin e etikës, krijimin e një sistemi efektiv kontrolli dhe eliminimin e praktikave joefikase.

Grupi punues si në pikën **I** të dispozitivit të këtij Vendimi, është përgjegjës që gjatë punës së tij të ketë parasysh të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë të përcaktuara si në pikën **II** të dispozitivit, si dhe të veprojë sipas udhëzimeve dhe procedurave standarde të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, me qëllim të krijimit të një mekanizmi institucional, i cili do të kontribuojë në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të funksionimit të institucionit. Nga ajo çfarë u theksua në arsyetim, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Shfuqizimi i vendimit nr.prot.02-020/04-0034928/22 i datës 18.05.2022, për ngritjen e grupit punues për hartimin e Planit të Integritetit 2022-2025, sipas pikës **V** të këtij vendimi bëhet mbi bazën e hyrjes në fuqi të Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit si dhe Vendimit 1476/23 të datës 26.07.2023, për Miratimin e Metodologjisë për Planet e Integritetit.

U dërgohet:

Anëtarëve të komisionit.

Agjencisë për parandalimin e Korrupsionit.

QSHQ/Arkivit.

Nr. Prot. 02-020/04-0061134/24
Podujevë, datë, 06.09.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

z.Mahmut Ajvazi, zyrtar për ndërtimtari në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se një muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 3

I përmenduri deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarit _____

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

I Autorizuari
Drejtorja e Inspeksionit
Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva

Nr.Prot. 02-02065-006.117/24
Podujevë, datë, 06.09.2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

V E N D I M

Neni 1

znj. **Blerina Zeka**, zyrtare për ndërtimtari në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, krahas punëve dhe detyrave nga pozita që mban autorizohet për kryerjen punëve dhe detyrave nga kompetencat dhe përgjegjësitë e inspektorit të ndërtimit në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Autorizimi sipas këtij vendimi lëshohet me qëllim të mbulimit të pozitës së inspektorit të ndërtimit dhe i njëjti vlen deri në rekrutimin e zyrtarit/es në pozitën e cekur konform rregullativës ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ, por jo më gjatë se një muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Neni 3

E përmendura deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së cekur.

Nënshkrimi i të autorizuarës *Blerina Zeka*

Neni 4

Për zbatimin e vendimit kujdesen Drejtoria e Inspeksionit, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si dhe Zyra e Personelit.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

E Autorizuara
Drejtorja e Inspeksionit
Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit
Zyra e Personelit
QSHQ/Arkiva

Nr. Prot. 02-020/05-0061121/24
Podujevë, datë, 06-09-2024

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, nxjerr:

URDHËRESË

I

Urdhërohet personeli i Drejtorisë së Inspeksionit, përkatësisht Inspektorët komunal që në çdo rast, në çdo situatë dhe në çdo kohë gjatë orarit të punës gjatë ushtrimit të funksionit të jenë me uniformën përkatëse / jelekët identifikues që i posedojnë.

II

Inspektorët komunal ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë përmes kontrollit dhe mbikëqyrjes inspektive në fushat përkatëse, në mënyrë të pavarur dhe profesionale, ndërmarrin masa, veprime dhe vendime përkatëse brenda afateve ligjore, në pajtim me ligjet dhe rregullativën ligjore në fuqi.

III

Për çdo lëshim eventual nga ana e inspektorëve komunal, nga kjo Urdhëresë konsiderohet shkelje e detyrave dhe përgjegjësive të punës dhe do të ndërmerren masa disiplinore dhe masa tjera ligjore.

IV

Për zbatimin e Urdhëresës kujdeset Drejtoria e Inspeksionit / personeli dhe Inspektorët komunal.

V

Urdhëresa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet:
Drejtorisë së Inspeksionit
QSHQ/Arkivit
Zyrës së personelit

Nr.Prot. 02-06/01-0061125/24
Podujevë, Datë, 06.09.2024

Kryetari i Komunës
Shpëjtim Bulliqi





KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13, 17 shkronja h) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 35.5 të Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikës e Kosovës, nenin 18 paragrafët 1, 2.2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo – Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar si dhe nenet 16, 19 parag. 1.8 dhe 61 parag.1.3 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit, nr. prot. 02-070/05-0061504/24, datë 10.09.2024, nxjerrë këtë;

VENDIM PËR EMËRIMIN E PËRKOHSHËM NË POZITËN E DREJTORIT TË SHKOLLËS FILLORE TË MESME TË ULËT - SHFMU “AFRIMI E FAHRIU “ NË FSHATIN LLUZHAN KOMUNA E PODUJEVËS

Neni 1

z. **Arbër Ymeri**, me nr. personal të letërnjoftimit [redacted] me vendbanim në fshatin Balloc Komuna e Podujevës, i kualifikuar MSC i Filozofisë,

Emërohet përkohësisht në pozitën e Drejtorit të SHFMU “Afrim e Fahriu” në fshatin Lluzhan, Komuna e Podujevës.

Neni 2

I përmenduri sipas nenit 1 të këtij vendimi emërohet përkohësisht deri në zgjedhjen/emërimin e Drejtorit sipas procedurës së rregullt të konkursit apo deri në një akt tjetër administrativ.

Neni 3

Kushtet e punës, të drejtat, përgjegjësitë dhe paga mujore caktohen me kontratën e punës.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Neni 5

Zbatimin e vendimit dhe çështjeve tjera që ndërlidhen me këtë vendim e bën Drejtoria e Arsimit.

*I dërgohet:
Drejtorisë së Arsimit
Të emëruarit
QSHQ/Arkivit*

Nr. prot. 02-016/01-0061970/24
Podujevë, datë: 11.09.2024





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenit 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në Rekomandim të Komisionit vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve për financim publik të ojq-ve në Komunën e Podujevës për organizimin e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive sipas Thirrjes publike nr. prot. 09-615/03-0045087/24 datë 11.07.2024, merr:

V E N D I M

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE ORGANIZATAT JOQEVERITARE-OJQ PËR ORGANIZIMIN E AKTIVITETEVE KULTURORE RINORE DHE SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Për financim publik të Organizatave Joqeveritare-OJQ, për realizimin e projekteve në fushën e aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive, sipas Thirrjes publike nr. prot. 09-615/03-0045087/24 datë 11.07.2024, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme **29,000.00 €**.

Neni 2

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, për kushtet dhe mënyrën e realizimit të aktiviteteve kulturore/rinore dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

Neni 3

Lista përfundimtare e përfituesve me shumat përkatëse është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. Prot. 02-400/01-0062388/24
Podujevë, datë: 13.09.2024



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenit 16 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr. prot.01-020/01-50862/18 dhe nenit 7 paragrafi 6, të Rregullores për Kushtet Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, nr.01-016/01-0030667/22, të datës 29.04.2022, merr:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR. PROT. 02-020/04-0017955/24 DATË 14.03.2024

Neni 1

Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi nr. prot 02-020/04-0017955/24 datë 14.03.2024 për ngritjen e Komisionit të veçantë për rastet dhe kërkesat individuale për ndarje të subvencioneve, dhe atë;

Në vend të Makfirete Zeka, anëtare e Komisionit caktohet **Xhevrie Beqiri** zyrtare në Zyrën për Komunitete dhe Kthim, ndërsa

Rilind Babatinca anëtar aktual i komisionit kalon në pozitën e kryesuesit të Komisionit.

Neni 2

Vendimi është pjesë përbërëse e vendimit nr. 02-020/04-0017955/24 datë 14.03.2024.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

*U dërgohet:
Anëtarëve të komisionit
Drejtorive përkatëse
QSHQ/Arkivit*

Nr. Prot 02-020/04-0063865/24
Podujevë, datë 20.04.2024


Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi